



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabusi i lëndës: Investimet dhe Menaxhimi i Portofolit

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Investimet dhe Menaxhimi i Portofolit
Niveli:	Master
Status i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II (Sems. III)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i Lëndës	Lënda "Investimet dhe Menaxhimi i Portofolit" është një kurs mjaftë i rëndësishëm për studentët e programit Master në Menaxhim Biznesi me specializim në Banka dhe Financa, i orientuar drejt kuptimit të thellë të investimeve financiare dhe menaxhimit të portofolios. Ky kurs është i ndarë në disa pjesë, duke siguruar një pasqyrë të gjerë për mënyrën se si funksionojnë tregjet financiare, teoritë e investimeve dhe strategjitë e menaxhimit të portofolios. Lënda studiohet si një modul semestral në vitin e dytë (semestri dimëror) që përfshin temat e letrave me vlerë dhe teorinë moderne të portofolios. Pjesët kryesore të lëndës: • <i>Pjesa e Parë: Tregjet Financiare dhe Llojet e Letrave me Vlerë</i> Ky seksion ofron një kuptim të thellë të ambientit të tregjeve financiare, duke përfshirë aktorët kryesorë që veprojnë në to. Studentët do të studiojnë llojet e ndryshme të letrave me vlerë, ku do të diskutohet se ku dhe si ato tregtohen në tregje të ndryshme. Do të shqyrtohen gjithashtu fondet e përbashkëta dhe firmat e investimeve, si dhe rëndësia e tyre si mjete investimi për individët dhe institucionet. • <i>Pjesa e Dytë: Teoria Moderne e Portofolios</i> Ky seksion përfshin thelbin e teorisë moderne të portofolios, i cili mbulon konceptet kryesore të kthimit, rezikut dhe optimizimit të portofolios. Studentët do të mësojnë si të përdorin modele të ndryshme indeks për të ndihmuar në optimizimin e portofolios, me fokus në

	balancimin e kthimit dhe rrezikut. Ky seksion siguron një bazë kryesore për të kuptuar strategjitë e diversifikimit dhe menaxhimit të riskut. • Pjesa e Tretë: Modelet e Çmimit të Kapitalit dhe Rreziku me Shumë Faktorë Kjo pjesë trajton teorinë e mimit të kapitalit (CAPM) dhe modelet e tjera të rrezikut që përfshijnë më shumë faktorë, duke diskutuar përdorimin e tyre për vlerësimin e aseteve dhe menaxhimin e riskut. Po ashtu, studentët do të studiojnë teorinë e arbitrazhit dhe hipotezën e tregut efikas, duke u njohur me logjikën dhe evidencat që mbështesin ose kundërshtojnë këtë teori. Do të shqyrtohen gjithashtu kritikët e racionalitetit të tregut në kontekstin e financave të sjelljes. • <i>Përfundimi: Evidenca Empirike dhe Vlerësimi i Letrave me Vlerë</i> Kursi mbyllet me një trajtim të evidencës empirike që mbështet teoritë e mësuara dhe mënyrat e vlerësimit të letrave me vlerë. Studentët do të kenë mundësinë të analizojnë aplikimin real të teorive dhe modeleve përmes studimeve të rastiit dhe të dhënave praktike.
Qëllimet e Lëndës:	• Të ofrojë një kuptim të plotë të funksionimit të tregjeve financiare dhe të letrave me vlerë. • Të zhvillojë aftësitë e studentëve për të analizuar dhe vlerësuar rrezikun dhe kthimin në portofolio. • Të ofrojë njohuri të avancuara për teknikat e optimizimit të portofolios dhe përdorimin e modeleve të investimeve. • Të shqyrtojë dhe të vlerësojë teoritë e mimit të kapitalit dhe ndikimin e tregjeve efikase dhe teorisë së sjelljes në investime. • Të sigurojë aftësi praktike për aplikimin e modeleve dhe metodologjive të investimeve për menaxhimin e portofolios dhe analizën e riskut.
Kush Mund ta Studiojë këtë Lëndë?	Ky kurs është i përshtatshëm për studentët e nivelit Master, të cilët kanë interes në financa, menaxhim të investimeve dhe analizën e riskut. Lënda është ideale për ata që duan të zhvillojnë aftësi të thella në investime dhe menaxhim portofolios dhe të bëhen profesionistë të aftë në analizën financiare dhe strategjitë e investimeve. Kjo lëndë është një mundësi e shkëlqyer për të zhvilluar njohuri dhe aftësi që mund të përdoren direkt në industri financiare, duke përfshirë bankat, firmat e investimeve, fondet e pensioneve, dhe shumë të tjera.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Njohuri (NJ): *NJ1: Të kuptojnë dhe të shpjegojnë mënyrën se si funksionojnë tregjet financiare dhe llojet e ndryshme të letrave me vlerë, duke përfshirë tregtimin e tyre në tregje të ndryshme dhe rolin e fondeve të përbashkëta dhe firmave të investimeve. *NJ2: Të njohin dhe të aplikojnë teorinë moderne të portofolios, përfshirë konceptet e kthimit, rrezikut dhe optimizimit të portofolios, si dhe metodat për balancimin e këtyre dy elementeve në një strategji investimi të qëndrueshme. *NJ3: Të kuptojnë modelet e çmimit të kapitalit (CAPM) dhe modelet e rrezikut me shumë faktorë, dhe të vlerësojnë efektivitetin e këtyre teorive në vlerësimin e aseteve dhe menaxhimin e riskut në kontekste të ndryshme financiare. *NJ4: Të analizojnë dhe të interpretojnë evidencën empirike që mbështet teorinë dhe modelet e mësuara, duke përfshirë përdorimin e metodologjive të vlerësimit të letrave me vlerë dhe analizës së portofolios në praktikë. Aplikim-Kompetenca (A-K): **A-K1: Të aplikojnë njohuritë mbi tregjet financiare dhe letrat me vlerë për të zhvilluar dhe menaxhuar portofolion financiar, duke përdorur teknika të optimizimit të portofolios dhe modelet e ndryshme të investimeve. **A-K2: Të përdorin modelet e teorisë moderne të portofolios për të analizuar dhe vlerësuar rrezikun dhe kthimin e portofolios, si dhe të përshtatin strategjitë e diversifikimit për të maksimizuar performancën e investimeve. **A-K3: Të përdorin dhe të zbatojnë metodologjitë e çmimit të kapitalit dhe modelet e rrezikut me shumë faktorë për të vlerësuar asete dhe për të menaxhuar riskun në një mjedis financiar të ndërlikuar dhe të ndryshueshëm. **A-K4: Të aplikojnë teknikat e investimeve për menaxhimin e riskut dhe optimizimin e performancës të portofolios, duke përdorur të dhëna reale dhe analiza të studimeve të rasteve për të marrë vendime të informuara. **A-K5: Të zhvillojnë aftësinë për të vlerësuar dhe përgatitur raporte për investimet dhe strategjitë e menaxhimit të portofolios, duke përfshirë përdorimin e analizës së riskut dhe kthimit për të siguruar optimizimin e vendimmarrjes. Aftësi (A): ***A1: Të demonstrojnë aftësi për të prezantuar dhe mbrojtur koncepte komplekse të investimeve dhe menaxhimit të portofolios për audiencë profesionale dhe akademike, duke përdorur argumente bindëse dhe analizë të thelluar. ***A2: Të zhvillojnë aftësi për të punuar në grupe dhe ekipe të ndryshme, duke kontribuar në projekte për zhvillimin dhe
---	--

	menaxhimin e strategjive të investimeve dhe menaxhimit të portofolios. ***A3: Të përdorin mjetet dhe teknologjitë bashkëkohore të informacionit për analizën dhe menaxhimin e të dhënave të investimeve dhe portofolios, përfshirë softuerët dhe aplikacionet e përdorura në industrinë financiare. ***A4: Të zhvillojnë aftësi kritike dhe analitike për të adresuar dhe zgjidhur probleme komplekse të investimeve, duke përdorur të dhëna empirike dhe teoritë e mësuara për të arritur vendime të qëndrueshme dhe të informuara. ***A5: Të demonstrojnë aftësi për të aplikuar njohuri të avancuara për menaxhimin e portofolios dhe investimeve për të optimizuar performancën e mundshme të portofolios dhe për të maksimizuar kthimin në përputhje me strategjitë e rrezikut dhe mundësitë financiare. Sqarim: Rezultatet e pritura të syllabusit janë të përpiluara konform rezultateve të pritura të programit, në përputhje me standardet e AKA-së. *Njohuri (Nj) **Aplikim-Kompetenca (A-K) ***Aftësi (A)		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	2	5	10
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	10	1	10
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10	1	10
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Totali			150
Sqarim: 1 orë = 25 ECTS kredi. Përshtatja e ECTS me orët totale: 150 orë ÷ 25 = 6 ECTS kredi.			
Metodologjia e mësimdhënies:	Lënda "Investime dhe Menaxhimi i Portofolit" do të zhvillohet në tri orë ligjërata dhe dy orë ushtrime, gjatë të cilave do të trajtohet materiali mësimor në detaje. Gjatë ligjëratave, do të përdoren metoda të ndryshme për të përmirësuar kuptimin dhe aplikimin e		

	teorive të investimeve dhe menaxhimit të portofolios. Do të zgjidhen detyra në tabelë, do të diskutohet mbi raste studimore nga praktika e biznesit në Kosovë dhe më gjerë, dhe do të përdoren hulumtime shkencore nga profesori i lëndës dhe kërkues të tjerë të fushës. Ushtrimet do të përfshijnë diskutime grupore, analizë kritike dhe kreative, zgjedhje të problemeve dhe teste vetëvlerësimi përmes programeve teknologjike të lidhura ngushtë me lëndën. Kjo do të ndihmojë studentët të zhvillojnë aftësi analitike dhe të kuptojnë më mirë aplikimin praktik të teorive të investimeve dhe menaxhimit të portofolios. Gjithashtu, gjatë ushtrimeve, do të zhvillohen diskutime mbi problematikat e ndryshme që lidhen me lëndën, si ato rajonale dhe vendore, si dhe mënyrat për t'i zgjidhur këto probleme në kontekstin e mjedisit global. Studentët do të inkurajohen të ndjekin zhvillimet dhe praktikën e investimeve dhe menaxhimit të portofolios në vend dhe në nivel ndërkombëtar. Pas çdo ore mësimore, do të jepen detyra për zgjidhje, të cilat do të diskutohen gjatë javës në vijim, si në orët e ligjëratis, ashtu edhe në ato të ushtrimeve. Mësimdhënia do të përqendrohet në inkurajimin e pjesëmarrjes aktive të studentëve, për t'u mundësuar atyre të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për t'u bërë profesionistë të aftë në këtë fushë. Mbajtja e ligjëratave dhe ushtrimeve do të realizohet në këtë format: • Prezantimi i temës në PowerPoint dhe zgjidhja e detyrave në tabelë. • Analiza e rasteve studimore të investimeve dhe menaxhimit të portofolios, të lidhura ngushtë me ligjëratën përkatëse. • Përsëritja e temave paraprake nga studentët. • Aplikimi i programeve të investimeve dhe menaxhimit të portofolios. • Analiza dhe diskutime nga ekspertë të ftuar të fushës, si në nivel vendor, ashtu edhe ndërkombëtar. • Raporte financiare, raste studimore dhe hulumtime nga industria e investimeve dhe menaxhimit të portofolios.
Metodat e vlerësimit:	• <i>Projekt shkencor:</i> 20% • <i>Ushtrime:</i> 20% • <i>Interaktivitet, pjesëmarrje dhe obligime tjera:</i> 10% • <i>Provimi përfundimtar:</i> 50% • Total 100% <u>Vlerësimi në % dhe nota përfundimtare</u> 91-100 = 10 (dhjetë) 81-90 = 9 (nëntë) 71-80 = 8 (tetë) 61-70 = 7 (shtatë) 51-60 = 6 (gjashtë) 0-50 = 5 (pesë)
Literatura	
Literatura bazë:	• <i>Ligjerata të përgatitura nga profesori i lëndës në fushën e</i>

	<i>investimeve dhe menaxhimit të portofolios.</i> • Zvi Bodie & Alex Kane & Alan Marcus – <i>Investimet 1</i>, Mediaprint, Tiranë, 2014 • Zvi Bodie & Alex Kane & Alan Marcus – <i>Investimet 2</i>, Mediaprint, Tiranë, 2015
Literatura shtesë:	• Edlira Luçi & Dorina Kripa – <i>Investime</i>, Tiranë, Pegi, 2016. ISBN: 978-99943-693-1-8 • Edlira Luçi & Dorina Kripa – <i>Investime (Teste, ushtrime dhe problema)</i>, Tiranë, Pegi, 2016. ISBN: 978-99943-40-95-8 • Sherif Bundo – <i>Drejtim Portfoli, Botimi 1</i>, AlbPaper 2007, ISBN: 9789995634100. • Literature ne gjuhe angleze: LIBRA • Literaturë në gjuhë angleze (hulumtime, raporte, analiza, pasqyra kontabel, diskutimet etj.) • Hulumtimet shkencore të profesorit të lëndës: https://www.researchgate.net/ • https://scholar.google.com/ • https://harvard.edu • https://www.freebookcentre.net/Business/Investments-Books.html

Plani i dizajnuar i mësimit:

Llogaritë e profesorit për të mbështetur studentët:

<https://harvard.edu/profile/lulajenkeleda> , Pasword:....

<https://classroom.google.com/u/2/lulajenkeleda> , Pasword:.....

<https://xipbooks.com/> , softwares.

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, metodat e punës dhe vlerësimit)
Java e dytë:	Mjedisi i Investimeve Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e tretë:	Klasat e Mjeteve dhe Instrumentet Financiare Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e katërt:	Tregtimi i Letrave më Vlerë Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e pestë:	Fondet e Përbashkëta dhe Kompani Tjera të Investimit Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e gjashtë:	Hyrje për Rrezikun, Kthimin nga Investimi dhe të Dhënat Historike Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e shtatë:	Kundërshtia ndaj rrezikut dhe Vendosja e Kapitalit në Mjetet më Rrezik Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e tetë:	Portofolet Optimale të Mjeteve më Rrezik Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e nëntë:	Modelet- Indeks Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e dhjetë	Modeli Çmimit të Kapitalit Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi

Java e njëmbëdhjetë:	Teoria e Çmimit sipas Arbitrazhit dhe Modelet Shumëfaktoriale të Rrezikut dhe Kthimit Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e dymbëdhjetë :	Hipoteza e Tregut Eficient Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e trembëdhjetë:	Financat e Sjelljes dhe Analiza Teknike Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e katërbëdhjetë:	Evidenca Empirike mbi Kthimin e Letrave më Vlerë Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi
Java e pesëmbëdhjetë:	Mbrojtje e projekteve hulumtuese dhe përgatitje për provimin final Hulumtim- Mendim Kritik- Zgjedhje Problemi

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Për çdo temë mësimore ,studentët do të pajisen më materiale të nevojshme në gjuhë shqipe,
- Në fund të çdo ore mësimore grupet e caktuara të studentëve do të angazhohen më detyrë apo rast studimi lidhur më temën e ligjëruesit, më çrast rezultatet e arritura nga kjo detyrë ,grupet e studentëve duhet të prezantojnë dhe ti diskutojnë ato në orën e ushtrimeve,
- Pjesëmarrja në ligjerata dhe ushtrime është e obliguar,
- Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve, Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shpesh dhe konsultime të studentëve,
- Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit ,por vlerësimi i tyre do të jetë dhe përqindja e provimit përfundimtar,
- Studentët inkurajohen të bëjnë vizita nëpër ndermarrje dhe të shohin aplikimin e kontabilitetit në praktikë.

Vërejtje për studentin:

- Para se gjithash studentin duhet të jetë i ndergjegjshëm dhe të respektojë Insitucionin, rregullat shkollore, çdo vendim dhe çdo rregullore lidhur më çështjet mësimore,
- Duhet të respektojë orarin e ligjeratave, ushtrimeve dhe të jetë i vemëndshëm në orën mësimore,
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID-kartelës në teste dhe në provim,
- Gjatë hartimit të punimit seminarik, studentin duhet tu përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit,
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj studentët duhet të përqendrohen vetëm në njohuritë personale, shkelja eventuale e ketyrë rregullave ndeshkohet konform vendimeve ,rregulloreve të parapara më statut dhe ligj.